



*Monitorimi i zbatimit të standardeve
ndërkombëtare në fushën e të drejtave të
pakicave në Mal të Zi*

RAPORTI
*mbi zbatimin e standardeve në fushën e
kulturës, arsimit, informacionit dhe
përdorimit zyrtar të gjuhës*

Botuesi:
Aleanca Qytetare

Për botuesin:
Milan Radoviq

Përgaditur nga:
stafi Aleancës Qytetare

Redaktori:
Milan Radoviq, Drejtori programor i Aleances Qytetare

Dizajni grafik:
Zoran Zola Vujachiq

Shtypi:
AP Print, Podgorica

Kopje:
150



MINISTARSTVO LJUDSKIH I MANJINSKIH PRAVA

Ky raport është përgatitur si pjesë e projektit "Zbatimi i të drejtave të pakicave - pasqyrim i multikulturalizmit në Malit të Zi" i realizuar nga Aleanca Qytetare, i financuar nga Ministria për te Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave të Qeverisë së Malit të Zi.

Përmbajtja

I HYRJE	4
II KUADRI METODOLOGJIK	6
III KORNIZA NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE	8
IV TË DREJTAT E PAKICAVE NË KUADRIMIN LIGJOR NË MAL TË ZI	12
V PËRDORIMI I GJUHËVE TË PAKICAVE DHE KOMUNITETEVE TJERA PAKICË NGA TRANSMETUESIT PUBLIK NË NIVEL KOMBËTAR DHE LOKAL	20
VI KONKLuzionet dhe Rekomandimet	26

**Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë
në dinjitet dhe të drejta**

(Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni 1)

I HYRJE

Të drejtat e përfaqësuesve të kombeve pakicë dhe të komuniteteve të tjera pakicë janë pjesë integrale e sistemit të mbrojtjes të drejtave të njeriut. Si të tilla, ato përbëjnë një nga shtyllat kyçe të sistemit juridik modern të çdo shteti demokratik, thellojnë parimet e shtetit të së drejtës, lirisë, barazisë, drejtësisë sociale dhe etno-kulturore.

Megjithëse vlefshmëria e mbrojtjes së këtyre të drejtave është e padiskutueshme dhe e vërtetuar në dokumente të shumta juridike ndërkombëtare, modelet e realizimit të këtyre të drejtave janë të ndryshme dhe të kushtëzuara nga shumë faktorë (historikë, ekonomikë, politikë), përfshirë sfidat me të cilat përballen demokracitë moderne sot. Megjithatë, është e padiskutueshme që të gjitha modelet që rregullojnë çështjet e përfaqësimit politik, autonomisë kulturore dhe pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në jetën publike duhet të drejtohen drejt integritit cilësor të pakicave kombëtare në jetën politike, sociale dhe ekonomike të çdo shteti, duke ruajtur diversitetin dhe veçantitë e tyre kulturore.

Kushtetuta e përcakton Malin e Zi si një shtet i drejtësisë civile, demokratike, ekologjike dhe sociale. Mbrojtja e të drejtave të pakicave është një kategori kushtetuese. Kuadri ligjor ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të pakicave është kryesisht i harmonizuar me dokumentet përkatëse ndërkombëtare. Krahas kuadrit normativ, viteve të fundit vërehet përparim i dukshëm në nivel institucional, me forcimin e mekanizmave mbështetëse dhe financiare për këshillat dhe organizatat e komuniteteve pakicë dhe përmirësimeve të caktuara në fushën e informimit dhe edukimit. Një nxitje e fortë për reforma në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave jep procesi i integritit evropian, nëpërmjet përmbushjes së kriterëve politike për anëtarësim në BE dhe në kuadër të procesit të negociatave në kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

Megjithatë, zbatimi i rregulloreve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të pakicave mbetet në zbatim i pabarabartë dhe i pamjaftueshëm. Është e nevojshme të sigurohet përfaqësim i barabartë i të gjitha pakicave në Kuvend. Në raportin e Komisionit Evropian për vitin 2021 thuhet se “**aktet nënligjore dhe mekanizmat institucionalë për promovimin dhe ruajtjen e të drejtave të personave që u përkasin pakicave janë zbatuar në mënyrë të pamjaftueshme**”.

Aleanca Qytetare, me mbështetjen e Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave të Qeverisë së Malit të Zi, realizon projektin "Zbatimi i të drejtave të pakicave - pasqyrim i multikulturalizmit në Malit të Zi" i cili synon të kontribuojë në respektimin më të madh të drejtave të popujve pakicë dhe bashkësive të tjera të pakicave në Mal të Zi. Monitorimi synon të sigurojë njohuri dhe informacion cilësor që janë baza e platformës së avokimit të Aleancës Qytetare në drejtim të mbrojtjes më efektive të të drejtave të popujve dhe të komuniteteve pakicë.

Aktiviteti kyç në këtë projekt ka të bëjë me monitorimin e punës së institucioneve në nivel shtetëror dhe vendor në lidhje me zbatimin e standardeve ligjore dhe ndërkom-bëtare për mbrojtjen e të drejtave të popujve pakicë dhe të komuniteteve pakicë, me qëllim të identifikimit të praktikave të mira në këtë fushë dhe promovimit të kulturave kombëtare në kontekstin e shoqëris qytetare dhe multikulturore në Mal të Zi. Fokusi është monitorimi i zbatimit të standardeve në fushën e promovimit të historisë dhe kulturës së pakicave, përmes sistemit të arsimit dhe informacionit.

Projekti përfshinte organet kompetente shtetërore, përkatësisht organet e adminis-tratës shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale, si dhe subjekte të tjera të rëndësishme, duke përfshirë këshillat kombëtare, mediat dhe organizatat joqeveritare që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të pakicave në Mal të Zi.

II KUADRI METODOLOGJIK

Monitorimi i zbatimit të standardeve ndërkombëtare, i kryer për qëllimet e projektit të sipërpërmendur, i referohet në radhë të parë ndalimit të diskriminimit, fushës së kulturës dhe medias, përdorimit të gjuhës dhe shkronjave, pjesëmarrjes demokratike dhe përfaqësimit të duhur të kombeve dhe të komuniteteve pakicë në sektorin publik, si dhe modalitetet për përmirësimin e punës së Këshillave kombëtare të popujve pakicë.

Monitorimi mbulon çështjen e ushtrimit të të drejtave politike, veçanërisht të së drejtës për të marrë pjesë në zgjedhje, të drejtën e votës dhe kandidimit - sipas sistemit të të drejtave të përgjithshme dhe të barabarta të votimit, të drejtën për të marrë pjesë në menaxhimin e çështjeve publike në të gjitha nivelet, si dhe të drejtën për të pasur qasje në funksione publike, në kushte të barabarta.

Për përgatitjen e kësaj analize është përdorur metoda përshkruese-cilësore, metoda induktive, në pjesën që i referohet përcaktimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve, me qëllim, ndër të tjera, të ndryshimit të zgjidhjeve ligjore të vlefshme.

Gjetjet dhe rekomandimet bazohen në rezultatet e analizës së kornizës normative për mbrojtjen e të drejtave të popujve dhe të komuniteteve pakicë në Mal të Zi në lidhje me standardet e përcaktuara ndërkombëtare, si dhe në të dhënat dhe komentet e marra nga aktorët kryesorë, këshillat kombëtarë, mediat dhe organizatat joqeveritare, sipas modelit të një pyetësoi të përgatitur dhe të shpërndarë.

Gjatë përgatitjes së raportit, janë përdorur informacione për përfaqësimin e pjesëtarëve të kombeve dhe komuniteteve pakicë në organet shtetërore dhe lokale, të themeluara nga shteti ose vetëqeverisja lokale, si dhe të dhëna lidhur me organizimin dhe punën e këshillave kombëtare.

Raporti ofron një analizë të rregulloreve dhe praktikës, në masën që ishte e mundur, duke marrë parasysh disponueshmërinë e të dhënave dhe faktin që disa nga aktorët përkatës nuk kanë paraqitur informacionin dhe propozimet e kërkuara. Një kontribut të veçantë në raport është analiza e përdorimit të gjuhëve të popujve dhe komuniteteve pakicë nga transmetuesit publikë në nivel shtetëror dhe lokal, analiza e teksteve të historisë që është e rëndësishme për të kuptuarit e arsimit në kontekstin e integritetit të komuniteteve pakicë.

III KORNIZA NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE

Standarde të shumta për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe etnike janë vendosur në dokumentet bashkëkohore ndërkombëtare, të cilat bazohen në marrëveshjet ndërkombëtare. Përmbajtja e dokumentave ndërkombëtare janë detyrimet dhe të drejtat e shteteve që kanë miratuar ato. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se sistemi i së drejtës ndërkombëtare u lë shteteve lirinë e plotë të vendimmarrjes lidhur me mënyrën se si do t'i përmbushin detyrimet e tyre ndërkombëtare në lidhje me rregullimin e sistemit për mbrojtjen e të drejtave të pakicave.¹

Nga pikëpamja historike, zhvillimi i përgjithshëm i sistemit juridik ndërkombëtar për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Evropë është i datës relativisht të re dhe lidhet me periudhën e pas Luftës së Parë Botërore, kur nëpërmjet veprimtarive të Lidhjes së Kombeve, u bënë përpjekje për rregullimin më të mirë dhe më të plotë të të drejtave të pakicave etno-kombëtare. Para kësaj, kjo lloj mbrojtjeje lidhej me komunitetet fetare, gjegjësisht pakicat fetare, por ndërkombëtarizimi i saj më domethënës erdhi pas miratimit të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, si dhe Deklarates të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Anëtarëve të Pakicave Etnike, Fetare ose Gjuhësore nga viti 1992, e cila praktikisht riprodhon dispozitën e nenit 27 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Konkretisht, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike shprehet në nenin 27: "*Në ato vende ku ka pakica etnike, fetare ose gjuhësore, personave që u përkasin atyre pakicave nuk duhet t'u mohohet e drejta për të gëzuar kulturën e tyre në bashkësi me anëtarët e tjerë të grupit të tyre, për të shpallur dhe shprehur besimin e tyre ose për të përdorur gjuhën e tyre.*"²

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si instrumenti më i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përcakton të drejtën formale të një individi për të aplikuar në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e të drejtave të tij të paraparë në Konventë. Konventa në nenin 1, të Protokollit

¹ Grupi i parë përfshin konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, të ratifikuara nga shtetet, ndërsa grupi i dytë përbëhet nga dokumente ndërkombëtare siç janë udhëzimet, opinionet, rekomandimet dhe deklaratat e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, duke përfshirë rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës për mbrojtjen e pakicave.

² Shih Komentin e Përgjithshëm nr. 23 (1994) të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut

nr. 12, përcakton se çdo e drejtë e parashikuar me ligj do të ushtrohet pa diskriminim mbi asnjë bazë, si p.sh. gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, besimi, bindjet politike dhe të tjera, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër. Më tej përcaktohet se autoritetet publike nuk do të diskriminojnë askënd për arsyt e lartpërmendura.

Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare përcakton detyrimin e shteteve për të garantuar barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë ligjore për anëtarët e pakicave kombëtare. Konventa gjithashtu i detyron shtetet të njohin të drejtën e çdo anëtarit të pakicës kombëtare për lirinë e shprehjes, e cila përfshin lirinë për të marrë dhe shpërndarë informacion në gjuhën e pakicës. Te neni 4 në Konventën Kuadër thuhet: "Palët kontraktuese marrin përsipër të garantojnë barazi para ligjit dhe mbrojtje të barabartë ligjore për anëtarët e pakicave kombëtare". Në këtë kuptim, çdo diskriminim i bazuar në përkatësinë e një pakice kombëtare do të ndalohet. Palët kontraktuese marrin përsipër të miratojnë, kur është e nevojshme, masat e duhura për të përmirësuar pjesëmarrjen e pakicave në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore si dhe për të arritur barazi të plotë dhe efektive midis anëtarëve të pakicës kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Në këtë aspekt, ata do të kenë parasysh kushtet e veçanta të pjesëtarëve të pakicave kombëtare".

Konventa rregullon gjithashtu të drejtën për të marrë dhe transmetuar informacion në gjuhën e pakicave. E drejta e dhënë ushtrohet pa ndërhyrje nga organet shtetërore. Shtetet angazhohen që të mos ndërhyjnë në krijimin dhe përdorimin e medias së shkruar, në të njëjtën kohë përcaktohen detyrimet shtetërore për dhënien e autorizimit për transmetimin e programeve radiotelevizive, pa diskriminim dhe bazuar në kritere objektive. Një detyrim shtesë i shtetit është të miratojë masat e duhura, duke përfshirë masat financiare si dhe ato që ndikojnë në zhvillimin e një politike të tillë që do të lehtësonte përqasjen në mjetet e informimit publik për popujt dhe komunitetet pakicë. Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Pakicë përpiket të ruajë gjuhët dhe dialektet evropiane të pakicave, ndër të tjera, përmes përdorimit më të madh të tyre në arsim dhe media, qoftë në jetën ekonomike dhe sociale. Në nenin 1, Karta jep një përkufizim të gjuhëve rajonale ose të pakicës, si "gjuhët që përdoren tradicionalisht në një territor të caktuar të një shteti nga qytetarët e atij shteti që përbëjnë një grup numerikisht më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë së atij shteti dhe cilat janë të ndryshme nga gjuha zyrtare e atij vendi, e cila nuk përfshin dialektet e gjuhës zyrtare të atij vendi ose gjuhët e punëtorëve migrantë." Territori ku përdoren gjuhët rajonale ose të pakicës nënkupton hapësirën gjeografike në të cilën gjuhët e përmendura janë mjete shprehëse të një numri të caktuar njerëzish; gjë që justifikon masat e ndryshme të mbrojtjes dhe përmirësimit të situatës në këto fusha, të cilat i parashikon Karta.

Përdorimi i emrave për anëtarët e pakicave etnike, fetare ose gjuhësore për pakicat nuk është i njëtrajtrashëm, as brenda vendit, as ndërkombëtarisht.³ Nuk ka asnjë instrument ndërkombëtar që përmban përkufizimin e pakicës dhe as shtetet nuk kanë një qëndrim të vetëm se kush duhet të konsiderohet anëtar i një pakice sipas kritereve objektive.

³ Nevoja për një përkufizim praktik të termit pakicë lindi gjatë zbatimit të nenit 27 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.. Për këtë arsye, raportuesi i posaçëm, Francesco Capotorti, propozoi që termi pakicë të nënkuptojë "një grup numerikisht inferior ndaj pjesës tjetër të popullsisë së një vendi, anëtarët e të cilit - si qytetarë të atij vendi - kanë veçori etnike, fetare ose gjuhësore. që i dallojnë ata nga pjesa tjetër e popullsisë dhe që, të paktën në mënyrë implicite, ndajnë një ndjenjë solidariteti të përqendruar në ruajtjen e kulturës, traditës, fesë dhe gjuhës së tyre "kombëtare", ndërsa pakicat etnike janë ato që janë pjesë e popullit. të cilët nuk janë shumicë në asnjë shtet, prandaj nuk e kanë shtetin e tyre "amë".

IV TË DREJTAT E PAKICAVE NË KUADRIMIN LIGJOR NË MAL TË ZI

Neni 6 i Kushtetutës së Malit të Zi garanton pacenueshmërinë e të drejtave dhe lirive të njeriut, ndalimin e nxitjes së urrejtjes (neni 7), si dhe ndalimin e diskriminimit të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë, mbi çdo bazë (neni 8).

Kushtetuta e Malit të Zi i garanton secilit të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit si dhe të drejtën për të ndryshuar besimin (neni 46). Gjithashtu, çdokujt i garantohet liria që, vetëm ose në bashkësi me të tjerët, të shprehë publikisht ose privatisht besimin e tij nëpërmjet lutjes, predikimeve, zakoneve ose riteve. Askush nuk është i detyruar të deklarojë besimet e tij fetare dhe besimet e tjera.

Neni 13 i Kushtetutës përcakton gjuhën dhe shkrimin në Mal të Zi. Në nenin e sipërpërmendur përcaktohet se gjuha malazeze është gjuhë zyrtare në Mal të Zi, ndërsa gjuhët serbe, boshnjake, shqipe dhe kroate janë në përdorim zyrtar. Mbrojtja e të drejtave të veçanta të pakicave garantohet me nenin 79 të Kushtetutës, i cili parashikon këto të drejta: shprehja, ruajtja, zhvillimi dhe shfaqja publike e veçorive kombëtare, etnike, kulturore dhe fetare:

- 1) për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit të tyre në përdorim privat, publik dhe zyrtar;
- 2) të shkollohen në gjuhën dhe shkrimin e tyre në institucionet shtetërore dhe programi mësimor të përfshijë historinë dhe kulturën e pjesëtarëve të kombeve dhe komuniteteve të tjera pakicë.;
- 3) që në zonat me pjesëmarrje të konsiderueshme në popullatë, organet e vetëqeverisjes lokale, organet shtetërore dhe gjyqësore të zhvillojnë procedurat në gjuhën e popujve dhe komuniteteve të tjera pakicë.;
- 4) të themelojë shoqata arsimore, kulturore dhe fetare me ndihmën materiale të shtetit;
- 5) të shënojnë dhe përdorin emrin dhe mbiemrin e tyre në gjuhën dhe shkrimin e tyre në dokumentet zyrtare;
- 6) në zonat me pjesëmarrje të konsiderueshme në popullatë, emrat tradicionale lokale, emrat e rrugëve dhe vendbanimeve, si dhe tabelat topografike duhet të shkruhen në gjuhën e popujve dhe komuniteteve të tjera pakicë;
- 7) për përfaqësim autentik në Parlamentin e Malit të Zi dhe kuvendet e njësisve të vetëqeverisjes lokale në të cilat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, në përputhje me parimin e aksionit afirmativ.;
- 8) përfaqësimin proporcional në shërbimet publike, organet shtetërore dhe të vetëqeverisjes lokale;
- 9) e drejta për informim në gjuhën e vet;

- 10) të krijojnë dhe mbajnë kontakte me qytetarët dhe shoqatat jashtë Malit të Zi me të cilët kanë origjinë të përbashkët kombëtare dhe etnike, trashëgimi kulturore dhe historike dhe besime fetare.;
- 11) për ngritjen e këshillave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të veçanta.

Në nenin 80, Kushtetuta ndalon asimilimin e anëtarëve të popujve dhe komuniteteve të tjera pakicë. Gjithashtu, Kushtetuta i garanton secilit të drejtën për t'iu drejtuar organizatave ndërkombëtare për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Liritë dhe të drejtat, të garantuara me Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj për të mbrojtur lirinë dhe të drejtat e njerëzve të tjerë, rendin juridik, moralin dhe shëndetin publik.

Ligji për Ndalimin e Diskriminimit ndalon çdo formë të diskriminimit mbi çfarëdo baze, duke përfshirë bazën e përkatësisë me një komb pakicë ose me gjuhën pakicë.⁴

E njëjta rregullore e përkufizon gjuhën e urrejtjes më afër: "Gjuha e urrejtjes është çdo formë e shprehjes së ideve, pretendimeve, informacioneve dhe opinioneve që përhap, nxit ose justifikon diskriminimin, urrejtjen ose dhunën kundër një personi ose grupi personash për shkak të karakteristikave të tyre personale: ksenofobia, urrejtja racore, antisemitizmi ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë, duke përfshirë intolerancën e shprehur në formën e nacionalizmit, diskriminimit dhe armiqësisë ndaj pakicave."

Kodi Penal i Malit të Zi, në nenin 42a, ka normuar një rrethanë të veçantë për dënimin për një vepër penale të kryer për shkak të urrejtjes në bazë të racës, besimit, përkatësisë kombëtare ose etnike, seksit, orientimit seksual ose identitetit gjinor të një personi tjetër, përveç nëse e njëjta është tashmë e normuar si vepër penale më e rëndë.

Pjesëtarët e popujve/ kombeve dhe komuniteteve pakicë kanë të drejtën e autonomisë kulturore, e cila manifestohet, ndër të tjera, përmes ruajtjes, zhvillimit dhe shprehjes së kulturës së tyre, si dhe ruajtjes së pasurive dhe traditave kulturore të kombeve dhe komuniteteve pakicë. Në këtë kontekst, pakicave kombëtare u garantohet e drejta e vetëqeverisjes në fushën e kulturës dhe në këtë kuptim mund të themelojnë këshilla kombëtare, institucione të veçanta kulturore, të cilat janë të pavarura në punën e tyre, ndërsa shteti mund të marrë pjesë në financimin e tyre.

Ligji për të drejtat dhe liritë e pakicave rregullon mënyrën e sigurimit dhe ushtrimit të të drejtave në bazë të shtetësisë, në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe rregullat e pranuar të së drejtës ndërkombëtare. Në nenin 8, ligji përcakton se popujt dhe komunitetet e tjera pakicë kanë të drejtë të shprehin, ruajnë, zhvillojnë, transmetojnë dhe shfaqin publikisht identitetin e tyre kombëtar, etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si pjesë e traditës së tyre.

⁴ Ligji për Ndalimin e Diskriminimit, neni 2.

Ligji përmban një përjasje të hapur në përcaktimin e identiteteve të pakicave. Përkatësisht, sipas nenit 2 të ligjit, popujt dhe komunitetet e tjera pakicë janë "çdo grup i qytetarëve të Malit të Zi, numerikisht më të vegjël se pjesa tjetër e popullsisë mbizotëruese, që ka karakteristika të përbashkëta etnike, fetare ose gjuhësore të ndryshme nga pjesa tjetër e popullsisë, historikisht e lidhur me Malin e Zi dhe motivohet nga dëshira për të shprehur dhe ruajtur identitetin kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar".

Fusha e përfaqësimit të pakicave në sektorin publik përcaktohet me nenin 25 të Ligjit për të drejtat dhe liritë e pakicave dhe mbron të drejtat e pakicave për përfaqësim proporcional në shërbimet publike, autoritetet shtetërore dhe administratën lokale, në përputhje me nenin 79 të këtij ligji të Kushtetutës së Malit të Zi.⁵

Sipas rezultateve të hulumtimit të kryer në 2019/2020 dhe të publikuar në vitin 2021, nga gjithsej 3,780 pyetësorë të plotësuar, në 224 organet që ishin përfshirë, punonjësit janë deklaruar në kuptim kombëtar si: Malazet 1930 (51.1%), Serb 711 (18.8. %), Mysliman 76 (2.0% krahasuar me 2.46% në 2015), Boshnjak 537 (14.2% krahasuar me 5.62% në 2015), Shqiptarë 242 (6.4% krahasuar me 2.51% në 2015), Romë 45 (1.2% krahasuar me 0.0202% në 2015), Egjiptian 10 (0.3%), kroat 31 (0.8% krahasuar me 0.76% në 2015), Jugosllav 6 (0.2%), Maqedonas 4 (0.1%), Hungarez 1, Rus 1, Slloven 1, nuk deklarohen 72 (1.9%), pa të dhëna 96 (2.5%), kombe të tjera 13 (0.3%), përkatësi rajonale 4 (0.1%). Për sa i përket tendencës së rritjes së këtij lloji përfaqësimi, vërehet një zhvendosje e caktuar, ndonëse jo më e theksuar krahasuar me trendin e parashikuar nga Strategjia e Politikave të Pakicave 2019-2023, e cila arrin në 20%. Përmirësimet janë të nevojshme kur bëhet fjalë për përfaqësimin në nivel të autoriteteve gjyqësore, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Përfaqësimi autentik i popujve pakicë, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar në Mal të Zi dhe komuniteteve të tjera pakicë në Kuvendin e Malit të Zi dhe kuvendet e vetëqeverisjes lokale, në të cilat ata përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, sigurohet në përputhje me parimin e aksionit afirmativ dhe në përputhje me legjislacionin gjedhor.

⁵ Për të mbledhur të dhëna të sakta dhe të besueshme për strukturën kombëtare të të punësuarve në organet në fjalë, që nga viti 2011 janë përpiluar informacione për përfaqësimin e popujve dhe komuniteteve të tjera pakicë në organet e vetëqeverisjes lokale, kompanitë dhe institucionet publike. Viteve të fundit, për shkak të pandemisë COVID dhe ndryshimeve në nivel institucional dhe politik, ka pasur një vonesë në zbatimin e hulumtimit të lartpërmendur, për këtë arsye nuk u përdoren të dhëna plotësisht të përditësuara në përgatitjen e këtij Raporti.

Çështja e përfaqësimit politik rregullohet me Ligjin për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, i cili në nenin 43, paragrafi 1, normon kushtet për përcaktimin dhe shpalljen e listës zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve, përkatësisht deputetëve, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni i referohet listave zgjedhore për zgjedhjen e përfaqësuesve që përfaqësojnë një popull ose një komunitet pakicë.⁶

Neni 94 i ligjit normon mënyrën e shpërndarjes së mandateve në të cilën marrin pjesë listat zgjedhore që kanë marrë së paku 3% të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme në njësinë zgjedhore. Si përjashtim nga kjo normë, listat zgjedhore për zgjedhjen e deputetit nga populli apo komuniteti pakicë, në rast se nuk e plotësojnë kushtin nga paragrafi 1 i këtij neni dhe individualisht marrin së paku 0.7% të votave të vlefshme, fitojnë të drejtën të marrin pjesë në shpërndarjen e mandateve si një listë zgjedhore kolektive me numrin total të votave të vlefshme të marra, me faktin se për llogaritjen e mandateve do të bëhet llogaritja që siguron deri në tre mandate. Kur bëhet fjalë për listën zgjedhore të përfaqësuesve të popullit kroat në Mal të Zi, nëse asnjëra nga listat e tyre nuk i plotëson kushtet e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 94, lista më e suksesshme prej tyre, me të paktën 0,35% të votave të vlefshme, fiton të drejtën e një mandati parlamentar.

Pikërisht kjo dispozitë rezultoi e diskutueshme në praktikë, duke pasur parasysh se Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor shprehu shqetësim në vitin 2018 lidhur me mungesën e përfaqësimit autentik të të gjitha grupeve të pakicave etnike dhe kombëtare, veçanërisht Romëve dhe Egjiptianëve. Në këtë drejtim, Komiteti urdhëroi marrjen e masave të veçanta për fuqizimin politik dhe social të komuniteteve minoritare rome dhe egjiptiane në Mal të Zi.

Në këtë kontekst, çështja kyçe është përqindja e përfaqësimit të një grupi të caktuar në kontekstin e ushtrimit të ndonjë të drejte të pakicës, në drejtim të zbatimit të parimit të aksionit afirmativ në raport me një komunitet të caktuar pakicë. Në rast konkret, kontestohen kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e dispozitave të Art. 94 të Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve, nga pikëpamja e cenimit të së drejtës së komunitetit rom për përfaqësim autentik adekuat në Parlamentin e Malit të Zi dhe në Kuvendet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale, në përputhje me parimin e aksionit afirmativ. Zgjidhja aktuale

⁶ (2) Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, për partitë politike që përfaqësojnë një popull ose komunitet pakicë, lista zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve mund të përcaktohet nëse mbështetet me nënshkrimin e së paku 150 votuesve, gjegjësisht për zgjedhje të deputetëve mund të pranohet nëse me nënshkrim e mbështetës të paktën 1000 votues, duke shfrytëzuar të drejtën nga neni 94, paragrafi 2 i këtij ligji. Në komunat ku mandati i këshilltarit kushtonte 150 ose më pak vota, në zgjedhjet e mëparshme, lista zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve mund të pranohet nëse e mbështet me nënshkrime përkatëse ai numër zgjedhësish që është për një më i vogël në krahasim me numrin e votave të nevojshme për të fituar mandatin e këshilltarit në zgjedhjet e mëparshme.

(3) Lista zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve që përfaqësojnë një popull ose komunitet pakicë me pjesëmarrje deri në 2% në popullsinë e përgjithshme të Malit të Zi, sipas rezultateve të regjistrimit të fundit, mund pranohet nëse mbështetet nga të paktën 300 votues me nënshkrimet e tyre..

ligjore duket e diskutueshme në lidhje me zbatimin e parimit të antidiskriminimit, duke pasur parasysh trajtimin e ndryshëm kur bëhet fjalë për kroatët.

Për sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë të pragut të përqindjes së normuar për realizimin e kësaj të drejte, Gjykata Kushtetuese u shpreh se nuk është kompetente të vlerësojë përshtatshmërinë e një zgjidhjeje të caktuar ligjore dhe as të vlerësojë përqindjen më të ulët të votave të vlefshme të fituara nga një popullatë e caktuar pakicë ose komunitet pakicë ("pragu zgjedhor"), pra për të vlerësuar nëse duhet të ishin normuar disa zgjidhje të tjera, të parashikuara nga iniciativa, sepse një vlerësim i tillë është ekskluzivisht në fushën e zhvillimit të politikës legjislative.

Rregullimi normativ në fushën e kulturës, informacionit dhe përdorimit të gjuhës

Neni 13 i Kushtetutës së Malit të Zi përcakton se gjuha malazeze është gjuhë zyrtare në Mal të Zi, ndërsa gjuhët serbe, boshnjake, shqipe dhe kroate janë në përdorim zyrtar. Neni 79 i Kushtetutës garanton që anëtarët e popujve dhe të komuniteteve pakicë kanë të drejtë të shprehin, ruajnë, zhvillojnë dhe shfaqin publikisht veçoritë e tyre kombëtare, etnike, kulturore dhe fetare; kanë të drejta për të zgjedhur, përdorur dhe nxjerrur në pah publikisht simbolet kombëtare dhe për të shënuar festat kombëtare; si dhe të drejtën për të përdorur gjuhën dhe shkrimin e vet në përdorim privat, publik dhe zyrtar dhe të drejtën për të marrë informacion në gjuhën e vet.

Në nenin e sipërpërmendur të Kushtetutës përcaktohet gjithashtu se në zonat me një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, emrat tradicionalë lokalë, emrat e rrugëve dhe vendbanimeve, si dhe tabelat topografike, shkruhen edhe në gjuhën e popujve dhe komuniteteve të tjera pakicë. Në Ligjin për Administratën Shtetërore⁷, Neni 8, normon që në organet e administratës shtetërore pakicat të ushtrojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit në përdorim zyrtar, si dhe të zhvillojnë procedurat në gjuhën e tyre në zonat me pjesëmarrje të konsiderueshme në popullatë, në përputhje me ligjin.⁸

Ekstraktet dhe çertifikatat nga regjistrat e lindjes për anëtarët e një kombi/populli ose komuniteti tjetër pakicë lëshohen gjithashtu në gjuhën dhe shkrimin e tij përkatës, në përputhje me ligjin. Në zbatimin e kësaj norme, aplikantit i lëshohet, pas kërkesës së tij, një ekstrakt nga regjistri i lindjeve, një ekstrakt nga regjistri i të vdekurve dhe një çertifikatë e shtetësisë malazeze, në formularët si vijon: gjuhë malazeze - shkrim latin; gjuha serbe - shkrimi qirilik; gjuha boshnjake - shkrimi latin (dygjuhësh)⁹; gjuha shqipe - me shkrimin shqip (dygjuhësh); gjuha kroate - shkrimi latin (dygjuhësh).

⁷ *Gazeta Zyrtare e Malit të Zi*, nr. 78/2018.

⁸ *E drejta e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit është e normuar në Ligjin për procedurën administrative, kështu që nëse pala nuk e kupton gjuhën malazeze sigurohet përkthim në gjuhën e saj ose në gjuhën që kupton.*

⁹ *Termi "dygjuhësh" do të thotë të shkruash në gjuhën malazeze me alfabetin latin, si gjuhë zyrtare dhe të shkruash në një nga gjuhët që janë në përdorim zyrtar.*

Për sa i përket zbatimit të këtyre zgjidhjeve normative në praktikë, megjithatë, ekzistojnë disa kufizime. Domethënë, disa dokumente personale lëshohen në dy gjuhë dhe si të tilla janë të vlefshme dhe pranohen si dokumente të lëshuara në gjuhën zyrtare. Megjithatë, ka kufizime, duke pasur parasysh se në formularët dygjuhëshe shënohet vetëm karta e identitetit, por jo pasaporta as patenta shoferitë. Nevojitet ndryshimi i kësaj praktike, nëpërmjet zbatimit konsekuent dhe adekuat të dispozitave për të drejtën e përdorimit të gjuhëve dhe shkronjave në përputhje me legjislacionin pozitiv dhe krijimit të mundësive teknike për zbatimin e plotë të këtyre dispozitave.

Përveç kësaj, përdorimi i gjuhës dhe i shkrimit në proceset gjyqësore, i cili është i detyrueshëm me ligj, në praktikë reduktohet ekskluzivisht në përdorimin e shërbimeve të përkthyesve, sepse procedurat gjyqësore zhvillohen ekskluzivisht në gjuhën zyrtare, d.m.th. në gjuhën malazeze (me praninë e një përkthyesi, për shembull, edhe kur të gjitha palët në proces janë me origjinë kombëtare shqiptare).

Ligji për zgjedhjen, përdorimin dhe shfaqjen publike të simboleve kombëtare rregullon të drejtën e zgjedhjes së lirë, përdorimit dhe shfaqjes publike të simboleve kombëtare të pjesëtarëve të kombeve dhe të komuniteteve të tjera pakicë. Neni 7 i ligjit normon që flamuri mund të vendoset gjatë tubimeve politike, shkencore, kulturore-artistike dhe sportive të organizuara nga këshillat, shoqatat, partitë politike dhe personat fizikë. Ndonëse dispozita është e qartë, ajo nuk shoqërohet me një dispozitë të përshtatshme penale që do të siguronte zbatimin efektiv të saj.

Ligji për kulturën¹⁰ rregullon punën e institucioneve kulturore, statusin dhe të drejtat e artistëve dhe ekspertëve të kulturës, inkurajimin dhe mbështetjen për zhvillimin e kulturës, financimin e veprimtarive kulturore dhe çështje të tjera me rëndësi për kulturën. Neni 3 i ligjit normon se kultura realizohet dhe bazohet në parimet e lirisë së krijimtarisë dhe respektimit të së drejtës për kulturë; angazhimin e shtetit dhe të vetëqeverisjes lokale për të nxitur dhe ndihmuar zhvillimin e krijimtarisë kulturore dhe artistike, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore; ruajtjen e barabartë e të gjitha identiteteve kulturore dhe respektimit të diversitetit kulturor.

Qendra për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave synon të promovojë, inkurajojë, ruajë dhe zhvillojë kulturën e pakicave, përmes organizimit të ngjarjeve të ndryshme, tryezave të rrumbullakëta, seminareve dhe prezantimeve, përmes botimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së programeve përmbajtësore në fushën e artit, muzikës, teatrit, letërsisë me qëllim të mbrojtjes të së drejtës për identitet kulturor, të drejtës për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe të drejtës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të popujve dhe të komuniteteve të tjera pakicë.

¹⁰ "Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 049/08 nga 15.08.2008, 016/11 nga 22.03.2011, 040/11 nga 08.08.2011, 038/12 nga 19.07.2012.

Qendra është themeluar nga Qeveria e Malit të Zi¹¹ si një institucion publik që merret me ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe traditave të pakicave dhe kontribuon në realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me promovimin e kulturës së popujve dhe të komuniteteve të tjera pakicë. Qendra ka një rol të rëndësishëm në ngritjen e nivelit të kohezionit social dhe kulturor dhe në uljen e shkallës së distancës etnike ndërmjet komuniteteve të ndryshme kombëtare në Mal të Zi. Në punën e saj Qendra bashkëpunon me institucionet kulturore në nivel kombëtar dhe vendor për të arritur qëllimet dhe objektivat e saja.

Ligji për Media,¹² në nenin 23 ndalon publikimin e informacioneve dhe opinionëve që nxisin diskriminim, urrejtjen ose dhunën ndaj personave ose grupeve të personave për shkak të përkatësisë ose mospërkatësisë së tyre racore, fetare, kombtare, etnike, gjinore ose seksuale, me përjashtim të rasteve kur informacioni publikohet dhe opinionet që janë pjesë e një vepre shkencore ose autori që trajton çështje publike dhe publikohen pa synimin për të nxitur diskriminim, urrejtje ose dhunë dhe janë pjesë e raportimit objektiv gazetaresk.

Ligji për mediat elektronike rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave juridikë dhe fizikë që kryejnë veprimtarinë e prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve mediatike audiovizive dhe shërbimeve të publikimeve elektronike nëpërmjet rrjeteve të komunikimit elektronik, si dhe kompetencat, statusin dhe burimet e financimit të Agjencisë për Media Elektronike, në përputhje me parimet e objektivitetit, ndalimit të diskriminimit dhe transparencës (neni 3, paragrafi 1, pika 7).

Neni 55 i Ligjit për Mediat Elektronike përcakton se "përdorimi i gjuhës malazeze nuk është i detyrueshëm në programet e destinuara për anëtarët e popujve dhe komuniteteve të tjera pakicë". Transmetuesit publikë prodhojnë dhe transmetojnë programe, pa diskriminim, veçanërisht duke marrë parasysh komunitetet pakicë; domethënë prodhojnë dhe transmetojnë programe që shprehin identitetin kulturor të popujve, grupeve kombëtare dhe etnike; prodhojnë dhe transmetojnë programe në gjuhën amtare të grupeve kombëtare dhe etnike në zonat ku banojnë (neni 74).

¹¹ *Gazeta Zyrtare e Malit të Zi* nr. 38/1, 27/07 nga 17.05.2007

¹² *"Gazeta Zyrtare e Malit të Zi"*, nr. 051/02 nga 23.09.2002, 062/02 nga 15.11.2002, *"Gazeta Zyrtare e Malit të Zi"*, nr. 046/10 nga 06.08.2010, 073/10 nga 10.12.2010, 040/11 nga 08.08.2011.

V PËRDORIMI I GJUHËVE TË POPUJVE PAKICË DHE TË KOMUNITETEVE TJERA NACIONALLE TË PAKICAVE NË TRANSMETUESIT PUBLIK TË NIVELIT NACIONAL DHE LOKAL

Kjo pjesë e Raportit ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve të pakicave dhe të komuniteteve tjera nacionale të pakicave në transmetuesit publik të nivelit nacional dhe lokal, në përputhje me dispozitat pozitive ligjore, veçanërisht në lidhje me nenin 79, paragrafi 1, pika 11 të Kushtetutës së Malit të Zi me të cilin garantohet e drejta e popujve pakicë për informim në gjuhët e tyre.¹³

Anëtarët/et e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të pakicave kanë të drejtën e themelimit të lirshëm dhe punën e papenguar të mediave të bazuar në lirinë e shprehjes së mendimit, hulumtimin, grumbullimin, përhapjen, publikimin dhe pranimin e informatave, qasjen e lirë të burimeve të informatave, mbrojtjen e personalitetit dhe dinjitetit të njeriut dhe qarkullimin e papenguar të informatave.

Autoritetet drejtuese dhe programore të themeluara nga Mali i Zi sigurojnë numrin përkatës të orëve për transmetimin e programit informativ, kulturor, arsimor, sportiv dhe argëtues në gjuhët e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të pakicave dhe të pjesëtarëve të tyre, si dhe të përmbajtjeve programore që kanë të bëjnë me jetën, traditën dhe kulturën e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të pakicave dhe të sigurojnë mjetet financiare për financimin e këtyre përmbajtjeve programore.

Përmbajtjet që kanë të bëjnë me jetën, kulturën dhe identitetin e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë transmetohen të paktën një herë në muaj, në gjuhën zyrtare, përmes serviseve publike. Në përputhje me mundësitë e veta financiare, Mali i Zi mund të sigurojë përkthimin (titrimin) e programit nga gjuhët e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë në gjuhën zyrtare, si dhe të ndërmarrë masa të tjera nxitëse për të siguruar transmetimin e përmbajtjeve programore në gjuhët e pakicave në programet ekzistuese radio dhe televizive.

¹³ Me Ligjin për të drejtat dhe liritë e pakicave, në nenin 12 është paraparë që popujve pakicë dhe komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë dhe përfaqësuesve të tyre i mundësohet liria e informimit në nivelin e standarteve të përcaktuara me dokumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e pakicave.

Servisi publik është i obliguar të prodhojë dhe transmetojë përmbajtje programore të dedikuara për të gjitha segmentet e shoqërisë, veçanërisht duke u kujdesur për pjesëtarët/et e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë, si dhe për afirmimin dhe kultivimin e identitetit të tyre kulturor dhe etnik.¹⁴

Obligimi i transmetuesve publikë për të prodhuar dhe transmetuar programe të dedikuara për pjesëtarët/et e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë, si dhe programe që shprehin identitetin kulturor dhe etnik të popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë, është përcaktuar me Ligjin për mediat elektronike.¹⁵ Në programet që janë të dedikuara në radhë të parë për pakicat, përdorimi i gjuhës malazeze nuk është i detyrueshëm.¹⁶

Këto detyrime të transmetuesve publikë për të promovuar multietnicitetin dhe ndërkulturën, duke nxitur prodhimin e programeve audiovizive dhe radiofonike në gjuhët e pakicave, janë në përputhje me rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për median dhe promovimin e tolerancës kulturore nga tetori i vitit 1997, i cili afirmon edhe ekzistencën e "diversitetit të punonjësve në shtëpitë mediatike në atë masë që korrespondon me karakterin multietnik dhe multikulturor të lexuesve, dëgjuesve dhe shikuesve".

Përveç detyrimeve programore të lartpërmendura, me kontratën ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe të emetuesit nacional publik, përcaktohen përmbajtjet programore në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e popujve pakicë dhe të komunitetet tjera nacionale të popujve pakicë.¹⁷

Ligji gjithashtu parasheh që mjetet për programet që kanë për qëllim ruajtjen e identitetit kulturor dhe etnik të komuniteteve pakicë të sigurohen nga buxheti i Malit të Zi ose i njësisë së vetëqeverisjes lokale.¹⁸

Detyrimet në aspektin e financimit të programit në gjuhët e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë janë të përshkruara edhe me Ligjin për mediat në mënyrën që pikërisht përmes Fondit për nxitjen e pluralizmit dhe diversitetit të mediave siguron një pjesë të mjeteve nga buxheti i Malit të Zi me qëllimin e ofrimit të shërbimeve publike, për të realizuar të drejtat e përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjin për përmbajtjet mediatike jo komerciale me interes publik.¹⁹ Është me

¹⁴ Ligji për Transmetuesin Nacional Publik Radio dhe Televizioni i Malit të Zi ("Fl. Zyrtare e Malit të Zi", Nr. 80/2020) datë 4.8.2020.

¹⁵ "Fl. Zyrtare e Malit të Zi", nr. 46/2010, 40/2011 - ligji tje., 53/2011, 6/2013, 55/2016, 92/2017 dhe 82/2020 - ligji tje.)

¹⁶ Ligji për Mediat Elektronike, neni 74.

¹⁷ Ligji për Mediat Elektronike, neni 76a.

¹⁸ Neni 76 i Ligjit për Mediat Elektronike.

¹⁹ Ligji për Media, neni 17.

rëndësi të theksohet edhe cilësia e programit të emetuar, respektivisht që programi nuk guxon të përmbajë idetë, pohimet dhe mendimet me natyrë diskriminuese²⁰.

Qeveria e Malit të Zi në qershor të vitit 2019 ka miratuar **Strategjinë e politikës së pakicave (2019-2023)**, në të cilën, përveç tjerash, parashihet zbatimi i aktiviteteve siç janë: Promovimi dhe implementimi i zgjidhjeve juridike pozitive nga fusha e përdorimit të gjuhës dhe shkrimit të pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale në nivel lokal. Me Planin e veprimit për Strategjinë e politikës së pakicave për vitin 2021 dhe 2022, në mes tjerash parashihet incizimi dhe emetimi i programit informativ dhe kulturo – arsimor në gjuhët e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë në servis nacional.

Me ratifikimin e Kartës evropiane për gjuhët rajonale dhe të popujve pakicë të Këshillit të Europës, Mali i Zi ka pranuar të mundësojë emetimin e përmbajtjet në gjuhët rajonale dhe të pakicave përmes mjeteve të informimit publik, si dhe të inkurajojë ose lehtësojë emetimin e rregullt të radioprogramit në gjuhët rajonale dhe të pakicave, si dhe të inkurajojë ose lehtësojë prodhimin dhe shpërndarjen e punimeve audio dhe audio-vizuale në gjuhët rajonale dhe të pakicave dhe të sigurojë masat e përkrahjes financiare për produksionin audio-vizual në gjuhët rajonale dhe të pakicave.

Mali i Zi po ashtu mori përsipër detyrimin të **garantojë lirinë e pranimit të drejtpërdrejtë të programit radio dhe televiziv nga vendet fqinje**, në gjuhë e cila është e njëjta ose e ngjashme me gjuhët rajonale ose të pakicave, si dhe mos të kundërshtojë ritransmetimin e programeve radio dhe televizive nga vendet fqinje në këtë gjuhë.

Në bazë të Kartës, Mali i Zi i ofron mbrojtje të veçantë gjuhës shqipe dhe asaj rome, por edhe mbrojtje të përgjithshme gjuhëve boshnjake dhe kroate për shkak të veçantisë nacionale dhe kulturore të Boshnjakëve dhe Kroatëve.

Sipas nenit 11 të Kartës evropiane për gjuhët rajonale të pakicave të Këshillit të Europës, që ka të bëjë me mjetet e informimit publik, Mali i Zi ka pranuar zbatimin e këtyre dispozitave për gjuhën shqipe dhe rome: duke mundësuar dispozitat të përshtatshme fal të cilave emetuesit e programit do të ofronin përmbajtje në gjuhët rajonale ose të pakicave; të inkurajojnë dhe të lehtësojnë emetimin e rregullt të radio programit në gjuhët rajonale dhe të pakicave; të inkurajojnë ose lehtësojnë emetimin e rregullt të programit televiziv në gjuhët rajonale dhe të pakicave; të inkurajojnë ose lehtësojnë prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve audio ose audio-vizuale në gjuhët rajonale dhe të pakicave; të inkurajojnë ose lehtësojnë krijimin dhe ruajtjen e të paktën një gazete në gjuhët rajonale ose të pakicave; të zbatojnë masat ekzistuese të përkrahjes financiare edhe për produksionin audio-vizual në gjuhët rajonale dhe të pakicave.

Në raportin e Komitetit të ekspertëve të Kartës europiane për gjuhët rajonale dhe të pakicave ceket se gjendja e gjuhëve rajonale ose të pakicave konsiderohen mjaft e kënaqshme kur bëhet fjalë për programin e Servisit publik, në veçanti sa i përket pranisë së gjuhës shqipe në media. Megjithatë, transmetuesit privat kanë informuar Komitetin e ekspertëve për mungesën e financimit të qëndrueshme të programeve të tyre në gjuhët e pakicave.²¹

Rezultatet e hulumtimit të kryer në një kampion prej 1163 të anketuarish në periudhën nga 1 shkurti deri më 15 prill 2022, me qëllim të shqyrtimit të qëndrimeve të pjesëtarëve/eve të pakicave për programet në gjuhët e pakicave dhe për kulturën dhe traditën e tyre²², vërehet se nuk ka pakicë që në një përqindje të madhe i ndjek transmetuesit publikë shumë shpesh ose relativisht shpesh, me një shkallë të caktuar devijimi të minoritetit kroat. Komuniteti kombëtar rom tregon të njëjtën shkallë interesi për të ndjekur transmetuesit publikë si minoritetet e tjera, pavarësisht nga fakti se numri i programeve dhe emisioneve të transmetuara nga transmetuesit publikë lokalë dhe kombëtarë në gjuhën rome është i kufizuar.

Kur bëhet fjalë për transmetuesit publikë, të anketuarit si zgjedhjen e parë, të dytë apo të tretë kanë përzgjedhur RTMZ (RTCG) si transmetuesin publik që e shikojnë më shpesh (73%), por ndjekin edhe punën e transmetuesve publikë lokalë. Sa i përket besimit në televizion dhe radio, të anketuarit kanë dhënë këto përgjigje: RTCG (36%), TV Vijesti (33.9%), Nova M (5.7%) dhe Prva TV (1.6%), ndërsa 21.8% e të anketuarve nuk i besojnë asnjë stacion televiziv. Kur bëhet fjalë për stacionet radiofonike, të anketuarit kanë besimin më të madh në Radion e Malit të Zi (10.9%), ndërsa përqindja më e lartë e të anketuarve nuk kanë një preferencë të theksuar për radio-stacione (78.2%).²³

Shumica e të anketuarve (59.2%) janë të njohur me faktin se ekzistojnë programe informative në gjuhët e pakicave dhe programe që promovojnë kulturat dhe zakonet e pakicave në Mal të Zi që transmetohen në transmetuesit publikë lokalë dhe nacional. Shumica e atyre që janë të njohur me faktin se ekzistojnë këto programe, më së shpeshti i ndjekin në RTCG (18.5% në radio-stacion dhe 73.3% në televizionin e Malit të Zi), ndërsa 8.3% i ndjekin në radiot dhe televizionet publike lokale. (4.2% në transmetuesit lokalë televizivë dhe 4.1% radio transmetuesit lokal).

²¹ <https://www.gov.me/dokumenta/c7f4a027-bf81-40ac-87ab-b81e895c6ba9>

²² Hulumtimi është realizuar për qëllimet e projektit "Për të respektuar më mirë të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare të popujve pakicë në Mal të Zi, mbështetur nga Fondi për Mbrojtjen dhe Realizimin e të Drejtave të Pakicave, duke përdorur metodën e pyetësorit me 9 pyetje operative dhe 5 pyetje demografike. Hulumtimi është kryer në bazë të një kampioni të rastësishëm dhe struktura e të anketuarve përbëhej nga 25.5% pjesëtarë të komunitetit kombëtar shqiptar, 22.4% të komunitetit kombëtar kroat, 21.8% anëtarë të boshnjakëve, 7.1% u deklaruan si myslimanë, 15.7% anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, ndërsa 7.6% e të anketuarve janë jashtë këtyre popujve dhe komuniteteve të përmendura të popujve pakicë.

²³ Rezultatet e hulumtimit mbi përdorimin e gjuhëve të popujve pakicë në përmbajtjen programore të transmetuesve publikë në nivel nacional dhe lokal - Legjislacioni dhe praktika, Aleanca Civile, Podgoricë, Qershor 2022.

Ajo që tregon nivelin e ulët të njohjes së gjuhës, kulturës dhe zakoneve të popujve pakicë në Mal të Zi, si dhe për informacionin e pamjaftueshëm për këto aspekte në transmetuesit publikë lokal dhe nacional, është fakti se 50% e të anketuarve janë të informuar vetëm pjesërisht për gjuhën, kulturën dhe zakonet e pakicave në Mal të Zi. Nëse kemi parasysh se shumica e të anketuarve i përkasin komuniteteve nacionale të pakicave, atëherë kjo e dhënë është edhe më alarmante. Më pak se një e katërta e të anketuarve ishin të informuar në masë të madhe për gjuhën, kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi, ndërsa vetëm 5% vlerësuan se ishin plotësisht të informuar.

Ata që janë të njohur me faktin se ekzistojnë programe informative në gjuhët e pakicave dhe programe që promovojnë kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi që transmetohen në transmetuesit publikë lokal dhe nacional, dhe që në të njëjtën kohë ndjekin këto programe (shumë shpesh, relativisht shpesh ose më së shumti ndjekin), shumica (45.5%) e vlerësuan cilësinë e këtyre programeve si "mirë", 30.6% i vlerësuan këto programe si "shumë të mira" ose "të shkëlqyera", ndërsa 9.6% i vlerësuan si jo mjaftueshëm të mira dhe vetëm 1.4% i vlerësuan programet si me "cilësi shumë të dobët".²⁴

Kur bëhet fjalë për promovimin e gjuhës, kulturës dhe zakoneve të komuniteteve të popujve pakicë në Mal të Zi, 59% e të anketuarve besojnë se Qeveria e Malit të Zi nuk kujdeset mjaftueshëm për të drejtat e pakicave (33.7% pjesërisht nuk pajtohen me deklaratën se "Qeveria e Malit të Zi kujdeset mjaftueshëm për të drejtat e popujve pakicë", ndërsa 25.3% nuk pajtohen plotësisht me këtë deklaratë). Gjithsej 30.3% e të anketuarve (vetëm 5.8% plotësisht) pajtohen me pohimin se "Qeveria e Malit të Zi kujdeset mjaftueshëm për të drejtat e popujve pakicë", ndërsa 10.7% e të anketuarve nuk kanë një mendim të caktuar.

Gjithsej 58,1% (38,7% pjesërisht dhe 18,7% plotësisht) nuk pajtohen me pohimin se "Qeveria dhe institucionet e tjera shtetërore investojnë mjaftueshëm në zhvillimin e përmbajtjes programore në programet e transmetuesve publikë", 27,9% pajtohen (vetëm 3,7% plotësisht), ndërsa 15% e të anketuarve nuk kanë qëndrim të caktuar.

Kur bëhet fjalë për transmetuesit publikë dhe programet e tyre në gjuhët e pakicave, 58% mendojnë se nuk e bëjnë këtë sa duhet, ndërsa 34,4% pajtohen me pohimin se "Transmetuesit publikë transmetojnë një numër të mjaftueshëm programesh/përmbajtjes në gjuhët e pakicave", prej të cilave vetëm 4% plotësisht dhe 30.4% pjesërisht, ndërsa 12.2% e të anketuarve nuk kanë një mendim të caktuar lidhur me këtë deklaratë.

²⁴ Rezultatet e hulumtimit mbi përdorimin e gjuhëve të popujve pakicë në përmbajtjen programore të transmetuesve publikë në nivel nacional dhe lokal - Legjislati dhe praktika, Aleanca Civile, Podgoricë, Qershor 2022.

Gjithashtu, shumica e të anketuarve (54,4%) nuk besojnë se transmetuesit publikë transmetojnë një numër të mjaftueshëm programesh/përmbajtjesh për kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi, ndërsa 33,1% pajtohen me pohimin se "Transmetuesit publikë transmetojnë një numër të mjaftueshëm të programeve/përmbajtjeve për kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi" (nga të cilat vetëm 4,6% në tërësi). 12.5% e të anketuarve nuk kishin asnjë mendim për këtë çështje.

Kur bëhet fjalë për cilësinë e programeve në gjuhën e pakicave dhe programeve për kulturën dhe zakonet e pakicave, 30.5% e të anketuarve besojnë se ato janë cilësor dhe nuk duhen ndryshuar, ndërsa vetëm 6.6% pajtohen plotësisht me pohimin. se këto programe në Mal të Zi janë të cilësisë së lartë dhe se ato nuk duhet të ndryshohen" (23,9% janë dakord pjesërisht). Gjithsej 53.3% e të anketuarve nuk pajtohen me pohimin e deklaruar, prej të cilëve 20.4% nuk pajtohen plotësisht, ndërsa 16.2% nuk kanë një qëndrim të qartë lidhur me këtë deklaratë.

Situata është pak më e favorshme kur bëhet fjalë për transmetuesit privatë. Gjegjësisht, 35.6% (nga të cilat 7.9% plotësisht) pajtohen me pohimin se "Programet e transmetuara nga transmetuesit privatë në gjuhën e popujve pakicë dhe për kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi janë të cilësisë më të lartë se ato të transmetuara nga transmetuesit publik", ndërsa 39.3% nuk pajtohen me këtë pohim (17.8% nuk pajtohen plotësisht). Megjithatë, duhet theksuar se 25.1% e të anketuarve nuk kanë një mendim të qartë.

Shumica e të anketuarve (61.4%) janë pajtuar me pohimin "Në Mal të Zi ndahen fonde të pamjaftueshme për programet në gjuhët e popujve pakicë dhe kulturën dhe zakonet e popujve pakicë në Mal të Zi" (28.1% plotësisht), dhe më pak se një e katërta e të anketuarve (më saktë, 23.6 %) nuk pajtohen me pohimin e deklaruar, ndërsa 15% nuk kanë një mendim të shprehur për këtë çështje.

VI KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Të drejtat e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë në Mal të Zi garantohen me Kushtetutën e Malit të Zi, me ligje dhe rregullore të tjera të miratuara në përputhje me Kushtetutën dhe dokumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Me gjithë përpjekjet e bëra nga autoritetet kompetente dhe vetëqeverisjet lokale në vitet e fundit, veçanërisht në kontekstin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, anëtarët e popujve pakicë dhe të komuniteteve tjera nacionale të popujve pakicë ende përballen me probleme në ushtrimin e të drejtave të tyre në masën e plotë. Gjuha e urrejtjes dhe intoleranca janë të pranishme në diskursin publik, të cilat shpesh janë të motivuara politikisht dhe kombëtarisht.²⁵

Mangësitë ekzistuese në aspektin e përfaqësimit autentik të pakicave në Parlamentin e Malit të Zi dhe në organet përfaqësuese në nivel lokal, si dhe në shërbimet dhe organet publike të themeluara nga shteti dhe pushteti lokal, ende nuk janë zgjidhur në mënyrë adekuate. Këto mangësi më së shumti reflektohen në shkallën e ulët të përfaqësimit të pakicave në nivel politik, kryesisht në pozita me rëndësi më të vogël, gjë që reflektohet në pjesëmarrjen e tyre joadekuate në vendimmarrje dhe kryerjen e detyrave me interes publik.

Ekziston një nevojë e qartë për të siguruar përfaqësimin autentik të pakicave përmes zgjidhjeve të reja ligjore në fushën e legjislacionit zgjedhor, duke përfshirë zgjidhjet e reja që lidhen me komunitetin rom, në mënyrë që të sigurohet përfaqësim autentik dhe proporcional i pakicave në jetën publike. Përmirësimet janë të nevojshme sa i përket nivelit të përfaqësimit të pakicave në punën e institucioneve të drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ministrive të tjera të rëndësishme.

Kur bëhet fjalë për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit, ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësim, duke pasur parasysh se ende nuk është siguruar zbatimi adekuat i dispozitave për të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe alfabetit në përputhje me legjislacionin pozitiv, ndër të tjera edhe përmes krijimit të mundësive teknike për zbatimin e plotë të këtyre dispozitave dhe zbatimin e vazhdueshëm të tyre në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale ku ekziston baza ligjore për këtë.

²⁵ *Tendenat tregojnë se, në krahasim me vitin 2018, regjistrohet niveli më i ulët i diskriminimit në bazë gjinore, bindjes politike dhe orientimit seksual, kurse niveli më i lartë në bazë kombësie, religjionit dhe invaliditetit, burimi: CEDEM, Këshilli Evropian: FORMAT DHE SHKALLA E DISKRIMINIMIT NË MAL TË ZI, Podgoricë 2020, fq. 21.*

Tërësia e ligjeve për median (Ligji për Mediat, Ligji për Mediat Elektronike dhe Ligji për Transmetuesin Publik Nacional të Radios dhe Televizionit të Malit të Zi) janë ligjërisht të harmonizuara me njëri-tjetrin dhe fusha e informimit është e rregulluar në përputhje me Kushtetutën dhe në nivelin e standardeve të përfshira në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut (OKB, OSBE, Këshilli i Europës, BE). Megjithatë, ka vend për të përmirësuar përfaqësimin e pakicave në shërbimet publike, duke pasur parasysh se të punësuarit janë kryesisht pjesëtarë të dy kombeve më të mëdha dhe vetëm ndonjëri vjen nga radhët e pakicave. Nga ana tjetër, këshillat e pakicave nuk kanë gazetat e tyre ose i kanë ato vetëm herë pas here, për shkak të mungesës së financimit adekuat. Një nga rekomandimet në këtë kontekst mund të jetë që këshillat kombëtare të kenë të paktën një përfaqësues në Këshillin e RTMZ-së (RTCG) dhe në shërbimet tjera publike, gjë që do të ndihmojë që interesat e përdoruesve/eve të gjuhëve rajonale ose të pakicave të përfaqësohen në organet përkatëse që, në përputhje me ligjin, afirmojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe liritë e medias.

Në lidhje me përfaqësimin mediatik të çështjeve që lidhen me të drejtat e pakicave, mbetet për t'u krijuar një aksion i përhershëm programor, jo vetëm në aspektin e prodhimit të përmbajtjes informative, por edhe të përmbajtjes dokumentaro-edukative që do të mundësojë njohjen më të mirë me zakonet dhe kulturën e pakicave dhe do të ndikojnë në forcimin e kohezionit social dhe kulturor në një shtet multi-etnik siç është Mali i Zi.²⁶

Pjesëmarrësit në hulumtimin e realizuar në kuadër të këtij projekti gjithashtu theksuan se redaksia e RTMZ-së (RTCG) duhet të forcohet nga të paktën një gazetar më shumë për gjuhën rome. Sa i përket gjuhës boshnjake dhe kroate, të cilat janë pjesë e sistemit të përbashkët gjuhësor pas gjuhës malazeze dhe serbe, është më e vështirë të përcaktohet çështja e përdorimit adekuat të gjuhëve të lartpërmendura në mjetet e informimit publik, por duhet të përmirësohen dhe përhapen përmbajtjet dhe programet që kanë të bëjnë me jetën, kulturën dhe zakonet e boshnjakëve dhe kroatëve në Mal të Zi. Është veçanërisht e nevojshme të punohet për mbrojtjen dhe promovimin e gjuhës dhe kulturës rome përmes mjeteve të informimit publik.

Kur bëhet fjalë për mediat lokale, përfaqësimi i pakicave ende nuk është adekuat. Transmetuesit lokalë (publik) transmetojnë programe në gjuhën shqipe në komunat e Ulqinit, Tuzit, Tivarit dhe Rozhajës, por frekuenca e tyre është mjaft e kufizuar.

E përbashkëta e të gjithë transmetuesve publikë lokalë është fakti se aspekti financiar i qëndrueshmërisë së tyre është shumë i diskutueshëm dhe se të gjithë transmetuesit

²⁶ Ky rekomandim rrjedh nga *Mendimi i tretë i Komitetit Këshillimor të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nationale në Mal të Zi*, në të cilin Komiteti inkurajon Malin e Zi të vazhdojë përpjekjet e tija për të informuar publikun përmes mediave për historinë dhe kulturën e popujve pakicë.

Veçanërisht u theksuan problemet financiare të disa transmetuesve publikë, si Radio Televizioni Ulqini dhe RTV Rozhajë.

publikë lokale luftojnë me (mos)qëndrueshmërinë financiare, gjë që sjell pamundësinë e dizajnit të programeve shtesë dhe më cilësore për pakicat.²⁷ Nga shërbimi publik nacional pohojnë se edhe situata e tyre financiare nuk është e kënaqshme.

Është veçanërisht e rëndësishme të sigurohet monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Europës në lidhje me zbatimin e vazhdueshëm të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale dhe Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakica, si dhe rekomandimet të organeve kontraktuese të Kombeve të Bashkuara.

Një kontribut për shqyrtimin e çështjes së prezantimit të kulturës dhe historisë së komuniteteve nacionale të pakicave në librat malazeze të historisë për shkollat fillore

Përmbledhje

Analiza e teksteve të historisë është bërë në kuadër të projektit “Aplikimi i të drejtave të pakicave – refleksioni i multikulturalizmit të Malit të Zi”, të cilin Aleanca Qytetare po e realizon me mbështetjen e Ministrisë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave.

Analiza synon të përcaktojë të dhënat sasiore dhe cilësore për shkallën dhe cilësinë e paraqitjes së historisë dhe kulturës së popujve pakicë në Mal të Zi, në bazë të të cilave Aleanca Civile, në bashkëpunim me partnerë nga sektori publik, do të vazhdojë të punojë për përmirësimin e sektorit arsimor dhe mundësive të tija për të kontribuar në forcimin e shoqërisë qytetare, gërshetimit multikulturor, njohjen e kulturave të ndryshme dhe eliminimin e stereotipeve dhe praktikave diskriminuese.

Analiza tregoi se tekstet shkollore të historisë, duke folur formalisht, respektojnë udhëzimet kyçe evropiane në lidhje me mësimdhënien cilësore të historisë dhe se ato përmbajnë një qasje mjaft të balancuar për paraqitjen e së kaluarës së përbashkët, pa gjuhën e urrejtjes dhe stereotipet diskriminuese. Megjithatë, tekstet shkollore fokusohen në historinë politike dhe të kaluarën përmes perspektivës së traditave shtetformuese nga mesjeta e deri në epokën më të fundit, duke lënë kështu në plan të dytë marrëdhëniet shoqërore, strukturat ekonomike dhe proceset kulturore - që do të përfaqësonin një kornizë ideale për shqyrtimin e dallimeve dhe ngjashmërive socio-kulturore brenda shoqërisë bashkëkohore malazeze.

Rrjedhimisht, Aleanca Qytetare ka formuluar një sërë rekomandimesh specifike për të rishikuar vetë modelin e teksteve shkollore të historisë, të cilat duhet t'u shërbejnë

²⁷ Veçanërisht u theksuan problemet financiare të disa transmetuesve publikë, si Radio Televizioni Ulqini dhe RTV Rozhajë.

institucioneve kompetente arsimore për përmirësimin e mëtejshëm të teksteve dhe mësimdhënies së historisë, në kuadër të edukimit qytetar.

Qëllimi i analizës dhe konteksti më i gjerë i projektit

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në ruajtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicave në praktikë dhe në përfaqësimin e barabartë të pakicave në zonat socio-kulturore në Mal të Zi në përputhje me Strategjinë e Politikës së Pakicave për periudhën 2019-2023. Realizimi i këtij projekti do të ndikojë në ngritjen e nivelit të zbatimit të Ligjit për të Drejtat e Pakicave dhe përmirësimin e gjendjes së minoriteteve përmes monitorimit, hulumtimit dhe inicimit të iniciativave për ndryshimin e kornizës ligjore bazuar në rekomandimet në fushën e sistemit arsimor, informimit dhe përdorimit të gjuhës zyrtare, si dhe përmes promovimit të të drejtave të pakicave në Mal të Zi dhe mundësisë së zbatimit të tyre.

Qëllimi specifik i projektit është përmirësimi i zbatimit të politikave të pakicave në fushën e promovimit të historisë dhe kulturës së pakicave përmes sistemit arsimor, sistemit të informimit dhe përdorimit zyrtar të gjuhëve në Mal të Zi. Realizimi i këtij projekti do të promovojë të drejtat e pakicave dhe mekanizmat e zbatimit të tyre, rezultatet e monitorimit dhe kërkimit do të vihen në dukje përmes iniciativës për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe aplikimit, publikimit dhe promovimit të botimeve, si dhe përmes ngritjes së kapaciteteve të përfaqësuesve të aktorëve socialë.

Standardet e Këshillit të Europës

Kjo analizë bazohet gjithashtu në disa nga dokumentet kryesore programore europiane, me anë të të cilave Këshilli i Europës u përpoq të përcaktojë parimet dhe udhëzimet bazë për hartimin dhe zbatimin e mësimdhënies cilësore të historisë, që synon promovimin e bashkëjetesës, depërtimit kulturor, si dhe ballafaqimin me të kaluarën në kontekstin e një të ardhmeje të përbashkët europiane.

*Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës (2001) 15 për mësimin e historisë në Europën e shekullit të 21-të*²⁸, i cili përmes Shtojcës së dokumentit bazë ofroi një pasqyrë gjithëpërfshirëse të qëllimeve të mësimdhënies cilësore të historisë, që synon në mes tjerash:

- ◆ përgatitjen e qytetarëve të përgjegjshëm dhe aktivë dhe zhvillimin e respektit për të gjithë llojet e dallimeve, bazuar në kuptimin e identitetit nacional dhe të parimit të tolerancës;
- ◆ pajtimin, pranimin, mirëkuptimin dhe besimin ndërmjet kombeve;
- ◆ përmirësimin e vlerave bazë si toleranca, mirëkuptimi i ndërsjellë, të drejtat e njeriut dhe demokracia;

²⁸ <https://rm.coe.int/16804ba53b>

- ◆ forcimi i identitetit individual dhe kolektiv të qytetarëve nëpërmjet njohjes së trashëgimisë së përbashkët historike në të gjitha dimensionet e saj - lokale, rajonale, kombëtare, europiane dhe globale²⁹;

Rekomandimi thekson edhe rëndësinë e "heqjes së paragjykimeve dhe stereotipeve duke theksuar në plan-programet e historisë ndikimet pozitive reciproke të vendeve, feve dhe shkollave të ndryshme të mendimit gjatë zhvillimit historik të Europës".

*Rekomandimi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës 1283 (1996) mbi historinë dhe të mësuarit rreth historisë në Europë*³⁰, thekson se ndërgjegjësimi për historinë duhet të jetë një nga elementët kryesorë të edukimit të të rinjve - "mësimi i historisë duhet t'u mundësojë studentëve të përvetësojnë aftësitë e të menduarit, për të analizuar dhe interpretuar në mënyrë cilësore informacionin, për të njohur kompleksitetin e temave historike dhe të vlerësojnë diversitetet kulturore". Gjithashtu, ky dokument i kushton vëmendje të konsiderueshme njohjes dhe eliminimit të stereotipeve, të mbështetur në baza kombëtare, racore, fetare apo të tjera.

Gjithashtu, thuhet se "lënda e mësimi të historisë duhet të jetë shumë e hapur. Ajo duhet të përfshijë të gjitha aspektet (historinë sociale, kulturore dhe politike). Duhet t'i jepet njohja e duhur rolit të gruas. Historia lokale dhe nacionale (por jo nacionaliste) duhet të studiohet, si dhe historia e pakicave. Ngjarjet e diskutueshme, të ndjeshme dhe tragjike duhet të balancohen me ndikime pozitive reciproke"³¹.

Gjithashtu, në *Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës 1880 (2009) mbi mësimin e historisë në zonat e konfliktit dhe pas konfliktit*³² thuhet se mësimi konvencional i historisë thekson një interpretim të ngjarjeve si "të vërtetë", ndërsa "është e pranuar ndërkombëtarisht se mund të ketë shumë këndvështrime dhe interpretime, të cilat bazohen në prova. Një qasje me shumë perspektiva ka vlefshmëri dhe ndihmon dhe inkurajon nxënësit të respektojnë dallimet kulturore" kundrejt mësimdhënies konvencionale, e cila mund të përforcojë aspektet më negative të nacionalizmit.

Së fundi, *Udhëzimet për Mësimdhënien cilësore të historisë në shekullin XXI (2018)*³³ bazohen në Kompetencat për Kulturën Demokratike³⁴ dhe u drejtohen kryesisht politikanëve dhe zyrtarëve publikë që janë përgjegjës për zhvillimin e programeve të mësimdhënies së historisë, por ato janë gjithashtu jashtëzakonisht të vlefshme për

²⁹ Ibid

³⁰ <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=15317&lang=en>

³¹ Ibid

³² <https://pace.coe.int/pdf/fd49bfabaaadfo3fo0265ce6bc6coe6f86b7277078968f76fcc7309f117693cd/recommendation%201880.pdf>

³³ <https://rm.coe.int/prems-10818-gbr-2507-quality-history-education-web-21x21/16808eace7>

³⁴ <https://rm.coe.int/prems-008418-gbr-2508-reference-framework-of-competences-vol-2-8573-co/16807bc66d>

personelin mësimor që punon për zbatimin e programit mësimor me studentët. Ashtu si dokumentet e përmendura më parë, Udhëzimet theksojnë rëndësinë e mësimdhënies së historisë në aspektin e të kuptuarit të kompleksitetit dhe diversitetit të sjelljes njerëzore në të kaluarën, dhe të inkurajimit të shqyrtimit të narrativëve të ndryshme, madje edhe të kundërta, të argumentimit të qëndrimeve dhe të kuptuarit të provave. Por "mësimi i historisë në shkolla mund të japë një kontribut të tillë vetëm nëse e bënë të mundur ajo që mësohet, si mësohet dhe cilësia e burimeve në dispozicion".

Si paraqiten historitë dhe kulturat e komuniteteve nacionale të pakicave në tekstet shkollore - treguesit sasiorë dhe cilësorë të analizës

Kjo analizë e paraqitjes së historisë dhe kulturës së komuniteteve nacionale të pakicave përbëhet nga disa tregues sasiorë dhe cilësorë. Në pjesën e parë matëm numrin e mësimëve për historinë malazeze në raport me numrin e të gjitha mësimëve në tekstet shkollore të historisë së klasave VI-IX, si dhe përqindjen e historisë malazeze në raport me numrin e përgjithshëm të faqeve të teksteve të historisë për shkollat fillore. Në këtë pjesë të analizës - si histori të Malit të Zi kemi analizuar të gjitha mësimet që mbulojnë historinë e territorit të shtetit të sotëm malazez.

Tabela përmban një pasqyrë bazë, të klasifikuar sipas klasës.

	Numri i përgjithshëm i mësimëve	Numri i mësimëve për historinë e Malit të Zi	Numri total i faqeve	Numri i faqeve me mësimet mbi historinë e Malit të Zi
klasa VI	24	1	106	5
klasa VII	21	6	74	19
klasa VIII	28	12	104	42
klasa e IX	26	7	128	27
Gjithsej	102	26 (25.5%)	412	93 (22.6%)

Sa i përket mësimëve të veçanta të komuniteteve nacionale të pakicave, në tekstet e historisë - në pjesën që ka të bëjë me historinë e Malit të Zi - vetëm komuniteti shqiptar është i përfaqësuar përmes mësimëve të veçanta - me nga 1 mësim në tekstet shkollore për klasat e 7-ta dhe të 9-ta. Është domethënëse se mësimi nga teksti shkollor për klasën e VII-të mbulon tërë hapësirën etnike shqiptare, ndërsa mësimi në tekstin për klasën e 9-të është i fokusuar në komunitetin shqiptar në Mal të Zi.

Me përjashtim të teksteve shkollore për klasën e 6-të, mësimet nga historia e Malit të Zi kanë mbulim relativisht të ekuilibruar me hapësirën e kushtuar mësimëve nga historia botërore (edhe pse do të ishte më e saktë të thuhet - europiane, sepse historia dhe kultura e zonave jashtë kontinentit të Europës pothuajse nuk janë të përfshira). Gjithashtu, në mësimet që kanë të bëjnë me historinë e rajonit/fqinjëve më të afërt, trajtohet rregullisht historia e Serbisë, BeH dhe Kroacisë (përfshirë Dubrovnikun).

Për më tepër, edhe pjesë shumë të ndjeshme të historisë së kësaj zone – si procesi i islamizimit, “hetimi e *poturicave*” dhe krimeve ndaj myslimanëve pas luftërave ballkanike – paraqiten pa stereotipe, duke përdorur fakte themelore historike, të vendosura qartë në kontekstin e proceseve dhe marrëdhënieve historike, pa lidhje mitomane të së shkuarës me kohën e sotme. Mund të thuhet me siguri se është respektuar një nga parimet kyçe të *Udhëzimeve të lartpërmendura të Këshillit të Europës*, në kuptimin e “*inkurajimit të shqyrtimit të narrativave të ndryshme, madje edhe të kundërta, qëndrimeve të argumentuara dhe kuptimit të provave*”.

Gjithashtu, është interesante të përmendet se në mësimin e tekstit shkollor për klasën e 9-të, që ka të bëjë me lëvizjet kuislinge në Mal të Zi gjatë Luftës së Dytë Botërore, pothuajse nuk përmenden *milicite* myslimane dhe lëvizja shqiptare Balli Kombëtar, por fokusi është në çetnikët dhe *zelenashët*.

Për sa i përket treguesve cilësorë, para së gjithash, duhet theksuar se tekstet e historisë për shkollën fillore janë pa stereotipe dhe paragjykime në baza kombëtare dhe fetare, por edhe asnjë shenjë të gjuhës së urrejtjes. **Nga ana tjetër, tekstet shkollore nuk bien ndesh me postulatet bazë të Këshillit të Europës** të mësimdhënies cilësore të historisë, që synon promovimin e bashkëjetesës, të gërshetimit kulturor, si dhe trajtimin e së shkuarës në kuadrin e një të ardhmeje të përbashkët europiane. Natyrisht, kjo nuk do të thotë se nuk ka disa pjesë që mund të përmirësohen (për shembull, përdorimi i termit *Arbanasi*³⁵, i cili është më shumë arkaik dhe i pa harmonizuar me pjesën tjetër të përmbajtjes së teksteve sesa ka një kuptim negativ).

Megjithatë, fakti që tekstet shkollore nuk bien ndesh me parimet e lartpërmendura, nuk do të thotë se konceptimi dhe përmbajtja e teksteve mundëson zbatimin e plotë të tyre.

Gjegjësisht, treguesit formal nuk flasin shumë për thelbin e çështjes së diskutuar, por edhe në atë nivel formal - është e dukshme se numri i mësimeve që përfaqësojnë historinë dhe kulturën e komuniteteve nacionale të pakicave nuk pasqyron rëndësinë dhe praninë e atyre komuniteteve në shoqërinë moderne malazeze. Megjithatë, këtu është jashtëzakonisht e rëndësishme të theksohet se vërejtja kryesore për mënyrën e paraqitjes së historisë dhe kulturës së komuniteteve nacionale të pakicave nuk është në aspektin formal të shifrave. Këtu kemi të bëjmë me një problem më kompleks - mënyrën në të cilën janë konceptuar vetë tekstet shkollore. **Respektivisht, historia e Malit të Zi në tekstet shkollore është prezantuar kryesisht përmes historisë politike, ndërsa aspektet kulturore, ekonomike dhe sociale janë mjaft të neglizhuara.**

Pra, nëse e përjashtojmë tekstin shkollor për klasën e 6-të me një orë mësimi për historinë e Malit të Zi - është një e dhënë mjaft domethënëse se në tekstet e historisë për klasën e 7/8/9 hapësira që i kushtohet historisë politike është shumë herë më e madhe se hapësira e dedikuar mësimeve nga proceset sociale, ekonomia dhe kultura (3.7 herë për sa i përket mësimeve). Kjo është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se fusha e historisë politike është pikërisht fusha në të cilën shprehen marrëdhëniet më konfliktuale ndërmjet komuniteteve nacionale.

Në këtë aspekt, historia politike e kësaj zone deri në fillim të shekullit të 20-të ndjek vertikalin dominues të qendrave shtetërore/dinastike - nga Vojislavleviqët, përmes Balshajve dhe Crnojeviqëve, deri te Petroviqët Edhe pse është një qasje plotësisht legjitime, e cila sigurisht duhet të ruajë një nga vendet qendrore, traditat historike të shoqërisë së sotme malazeze, të cilat jo gjithmonë kanë qenë të lidhura drejtpërdrejt me qendrat e lartpërmendura shtetformuese gjatë historisë (p.sh. Boka e Kotorrit dhe Sanxhaku) u zhvendosën në plan të dytë.

Gjithashtu, shumica e komuniteteve nacionale (duke përfshirë edhe më të madhin - malazez) nuk prezantohen përmes mësimeve të ndara dhe as përmbajtja e tekstit nuk shtjellon specifikat e tyre kulturore dhe sociale përmes historisë dhe marrëdhënieve të ndërsjella - përkundrazi, e kaluara e kësaj zone vështrohet në mënyrë dominuese përmes historisë së idesë shtetndërtuese - nga Vojislavleviqët deri te Petroviqët e kështu me radhë, deri në periudhën jugosllave. Meqë kjo përvojë shtetformuese, veçanërisht nga koha e dinastisë Petroviq Njegosh, ka vulën dominuese të popullit malazez - komunitetet e tjera nacionale në mënyrë indirekte janë lënë në plan të dytë. **Gjithashtu, komuniteti rom pothuajse nuk përmendet në tekstet shkollore të historisë.**

Rekomandimet

- ◆ Rekomandimi kryesor lidhet me stimulimin e atyre aspekteve të historisë që promovojnë vlera dhe tradita të përbashkëta, në mënyrë që nxënësit gjatë kësaj pjese

të arsimimit të inkurajohen të mendojnë në atë drejtim, në vend që të vëzhgojnë historitë e ndryshme të komuniteteve nacionale që "fal rrethanave" ekzistojnë brenda një shteti të përbashkët.

- ◆ Midis ekstremeve - injorimit të komuniteteve nacionale të pakicave dhe reduktimin e historisë së një shoqërie në historitë e komuniteteve nacionale që janë vetëm formalisht të lidhura - është e nevojshme të hartohet një qasje programatike që do të promovonte specifikat e komuniteteve të ndryshme (dhe jo vetëm kombëtare ose fetare, sepse ato nuk janë të vetmet korniza identitare) në frymën e unitetit shoqëror dhe të kuadrit modern shtetëror. Përndryshe, duke e imponuar narrativën shtetërore dhe duke injoruar specifikat e komuniteteve nacionale brenda kësaj narrative - humben mundësitë për një lidhje më të qartë të këtyre komuniteteve nacionale dhe mirëkuptimit e njohjes reciproke.
- ◆ Do të ishte e rëndësishme të zvogëlohej pjesa e historisë politike në përmbajtjen e teksteve shkollore, në favor të përmbajtjeve nga historia e proceseve shoqërore, ekonomisë dhe kulturës. Kjo është në përputhje me rekomandimin e Komitetit, i cili rekomandon që shteti të dyfishojë përpjekjet e tij për të përmirësuar përfaqësimin e të gjitha grupeve të pakicave etnike dhe kombëtare, veçanërisht romëve dhe egjiptianëve, në jetën politike dhe publike.
- ◆ Brenda asaj hapësire - të promovohen tema që i tejkalojnë dallimet nacionale, dhe përmes përmbajtjes shoqëruese të hulumtohet rëndësia e tyre për marrëdhëniet e komuniteteve të ndryshme gjatë historisë. Me një qasje të tillë, nxënësit e shkollës fillore do të mësonin shumë më tepër për mënyrën e jetesës përmes historisë, marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, zhvillimin e strukturave shoqërore, ndikimin e natyrës dhe gjeografisë në zakonet sociale dhe ekonomike, etj. (p.sh. zakonet e zonave malore dhe bregdetare, zonave rurale dhe urbane, etj.).
- ◆ Të rriten përmbajtjet antropologjike (p.sh. zakonet e përbashkëta të komuniteteve të ndryshme, përvojat e bashkëjetesës dhe integritimit kulturor), duke përfshirë disa lexime të reja interesante të së kaluarës - siç është historia e grave, d.m.th. pozita e gruas në shoqëri gjatë historisë - me karakteristika të përbashkëta për të gjitha komunitetet nacionale dhe specifika për secilin në veçanti.
- ◆ Në të njëjtën mënyrë që tekstet shkollore ofrojnë një pasqyrë historike të ideve të shtetndërtimit, do të ishte e këshillueshme që të konsiderohen disa vertikale të tjera historike - si historia e arsimit, kujdesi shëndetësor, traditat urbane ose ekonomia - dhe përmes kësaj narrative të paraqiten marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve etnike ose specifikat e tyre.

